



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

## NJOFTIM

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të shoqërisë Lotos-Air BP Polska sp.z.o.o nga shoqëria Aramco Overseas Company B.V.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i propozuar lidhur me blerjen e 50% të aksioneve të shoqërisë Lotos-Air BP Polska sp.z.o.o nga shoqëria Aramco Overseas Company B.V.

Referuar dokumentit “Marrëveshje paraprake për blerjen e aksioneve”, palët në marrëveshje janë:

**Pala blerëse: Aramco Overseas Company B.V.**, një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Hollandës me objekt aktiviteti: Dizenjim teknik dhe konsulencë inxhinierike e të tjera; shoqëri holding; shoqëri pjesëmarrëse.

AOC B.V, është një shoqëri e zotëruar tërësisht nga Saudi Arabian Oil Company, e cila realizon të ardhura në Shqipëri, nëpërmjet tregtimit dhe shitjes së hidrokarbureve dhe lëndëve të tjera derivate

**Pala shitëse: Grupa Lotos SA**, një shoqëri aksionere e themeluar sipas legjislacionit të Polonisë, me objekt aktiviteti: Prodhim dhe përpunim produktesh nga rafineritë e naftës; transport me tubacion; prodhim i kimikateve të tjera bazë organike; magazinim dhe ruajtja e mallrave; shitje me shumicë e karburanteve dhe produkteve derivate etj.

**Shoqëria Target: Lotos-Air BP Polska sp.z.o.o**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Polonisë, me objekt aktiviteti: Shitje me shumicë karburanti dhe produkte derivate; veprimtari e agjentëve që merren me shitjen e karburanti, mineraleve, metaleve dhe kimikateve industriale; magazinimi dhe ruajtja e mallrave të tjerë; veprimtari mbështetëse për transportin ajror etj.

BP Europa SE është një filial indirekt i BP p.l.c, pjesë e grupit BP, e cila është prezente dhe realizon të ardhura në Shqipëri përmes filialit të saj

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i

kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**